

Nr: 1605 Prot

dt: 27.04.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "Luigj Gurakuqi"
FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE

DEKANI

Nr. 220 prot.

Shkodër, më 27.4. 2026

Lënda: *Shkresë përcjellëse e kërkesës për publikimin e kriterëve të programit të studimit Doktoratë në "Gjuhë shqipe"*

Drejtuar :

Prof. dr. Tonin GJURAJ

Rektor i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Bashkëngjitur po ju dërgojmë kërkesën e QSA për publikimin e kriterëve të programit të studimit Doktoratë në "Gjuhë shqipe".





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Fakulteti i Shkencave Shoqërore
Qendra e Studimeve Albanologjike

Nr ____ prot.

Shkodër, më 24.04.2026

Lënda : *Kërkesë për shpalljen e kriterëve të programit të studimit Doktoratë në "Gjuhë Shqipe"*

Drejtuar :

Prof. dr. Tonin GJURAJ
Rektor i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Prof. dr. Artan HAXHI
Dekan i Fakultetit të Shkencave Shoqërore

Mbështetur në shkresën nr. 2737, të datës 08. 04. 2026, përcjellë nga Ministria e Arsimit, ku konfirmohet lista e udhëheqësve shkencorë për programin e studimit të ciklit të tretë, Doktoratë në "Gjuhë shqipe" dhe në vendimin e Senatit akademik të USH nr.17, datë 23. 01. 2024 "Për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve për vitin akademik 2025 - 2026", kërkojmë shpalljen e kriterëve për aplikim në këtë program studimi në faqen zyrtare të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" (bashkëngjitur Vendimi i Senatit akademik për kriteret).

**KRITERET E PRANIMIT NË PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË
DOKTORATË NË 'GJUHË SHQIPE'**

Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për t'u përfshirë në programin e studimit të ciklit të tretë Doktoratë në "Gjuhë shqipe" për vitin akademik 2025-26 do të jenë:

1. të ketë përfunduar studimet e larta në Gjuhë-Letërsi ose Gjuhë e huaj.
2. të ketë përfunduar studimet e ciklit të dytë në **profilin gjuhësi**;
3. të zotërojë të paktën njëren nga diplomat 'Master i Shkencave', 'Master i Arteve', 'Diplomë e integruar e Nivelit të Dytë', 'Diplomë e Nivelit të Dytë', 'Diplomë Master Ekzekutiv', Diplomë e lëshuar në Republikën e Shqipërisë për programin e studimit që ka zgjatur, së paku, 4 vite akademike (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve, sipas parimeve të procesit të Bolonjës, apo diplomë nga një program studimi të barasvlefshëm të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga Ministria e Arsimit në Shqipëri;
4. të ketë notë mesatare të përgjithshme në studimet e ciklit të parë dhe të dytë jo më të ulët se **8.00** ose të ketë fituar jo më pak se 80% të pikëve totale nga vlerësimi përkatës për studimet e kryera jashtë vendit;
5. të njohë në nivelin **B2** një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht ose spanjisht), e vërtetuar përmes testeve të njohura

ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse individit ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.


Aplikanti për të ndjekur programin e studimit të doktoratës bën një kërkesë dhe dorëzon dokumentet e mëposhtme:

1. Curriculum vitae;
2. Kopje të noterizuar të diplomave, të shoqëruara me suplementet e diplomës ose listën e notave me kreditet përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes/ekuivalentimit nga ministria përgjegjëse për arsimin; kopje të noterizuar të diplomave të ciklit të tretë "*Master ekzekutiv*", diplomë specializimi afatgjatë, ose të diplomave ekuivalente me to, shoqëruar me listën e notave ose suplementin e diplomës, nëse kandidati ka të tilla;
3. Fotokopje të kartës së identitetit/pasaportës;
4. Dy rekomandime nga personel akademik me titull "*Profesor i asociuar*" ose "*Profesor*";
5. Dëshmi të gjuhës së huaj;
6. Vetëdeklarim i studentit për përballimin e shpenzimeve të programit të studimeve të doktoratës, nëse do të vetëfinancohet;
7. Projekt-propozimi, i hartuar nga kandidati, ku evidentohen objektivat e kërkimit shkencor, metodologjia që do të ndiqet, nevoja për studim të thelluar në fushën e propozuar dhe risitë që pritet të sjellë punimi, plani i punës kërkimore shkencore i ndarë në vite, si dhe mundësia që studimi të mbulohet nga grante kërkimore-shkencore;
8. Vërtetim nga qendra e punës, kur kandidati ka eksperiencë pune akademike në fushën përkatëse pranë një institucioni të arsimit të lartë apo ka eksperiencë pune si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar në fushën përkatëse;
9. Mandat pagese për tarifën e aplikimit;
10. Vetëdeklarim të aplikantit se do të zbatojë standardet shkencore dhe etike;
11. Dy fotografi.

Dokumentet do të dorëzohen pranë sekretares së Qendrës së Studimeve Albanologjike, Fakulteti i Shkencave Shoqërore nga data **28 prill deri më 28 maj 2026**.

Drejtuesi i QSA

Prof. as. dr. Zamira SHKRELI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 231 prot.

Shkodër, më 23 . 01 . 2024

V E N D I M

Nr. 17 , datë 23 . 01 . 2024

"Për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve për vitin akademik 2025-2026"

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 72, 74, dhe 76; Statutin e USH-së Neni 17, pika 6, germa "o", Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 23.01.2024

Vendosi:

1. Miratimin e kriterëve për kandidatët konkurues që aplikojnë për të ndjekur studimet me kohë të plotë pranë USH-së për vitin akademik 2025-2026 (materiali bashkangjitur).
2. Ky vendim t'i përcillet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

Prof. Dr. Rajmonda KËÇIRA



KRITERET E PRANIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2025 – 2026
CIKLI I DYTË, MASTER PROFESIONAL DHE MASTER SHKENCOR

KRITERET E PRANIMIT NE UNIVERSITETE 2025 - 2026			
Cikli i dytë i Studimeve Master Profesional dhe Master Shkencor			
IAL	Fakulteti	Programi i studimit	Kriteret
	Fakulteti i Shkencave Shogërore	Master Shkencor në "Etnokulturë dhe Letërsi shqipe"	<p>Të zotërojnë diplomë universitare Bachelor në Gjuhë - Letërsi, Çikël i ulët, ose diploma ekuivalente me to, me kohë të plotë apo me kohë të pjesshme, të fituara brenda apo jashtë vendit të klasifikuara sipas ligjit të IAL 80/2015 dhe akteve nënligjore në fuqi.</p> <p>Nota mesatare në progresion zbritës, nga nota më e lartë tek më e ulëta, në përputhje me kuota e përcaktuara për programin e studimit.</p> <p>-Nëse konkurojnë më shumë kandidatë se ka kuota në dispozicion dhe kanë të njëjtën diplomë të profilit studimor, të njëjtën mesatare si dhe kanë kryer Bachelor në USH, atëherë shpallet fitues kandidati i cili në Provimin e Diplomës/Punimin e Diplomës ka notën më të lartë. Nëse dhe ky rast është i njëjtë, fituesi caktohet me short në prani të një komisioni ad-hoc.</p> <p>-Të zotërojnë diplomë universitare Bachelor në Gjuhë - Letërsi ose diplomë ekuivalente me të, me kohë të plotë ose të pjesshme, të fituar Brenda dhe jashtë vendit të njohur dhe të klasifikuar sipas ligjit të IAL 80/2015 dhe akteve nënligjore në fuqi.</p> <p>-Kriter kryesor për përzgjedhjen e kandidatëve fitues është nota mesatare në progresion zbritës, nga nota më e</p>
		Master Shkencor Studime të thelhara në Gjuhësi	

SIGURIM I JURAKU

INSHKOLLER

INSHKOLLER

		<p>lantë tek më e ulta, në përputhje me kuotat e përcaktuara për këtë program studimi.</p> <p>-Nëse konkurojnë më shumë kandidatë se ka kuota në dispozicion dhe kanë të njëjten diplomë të profilit studimor, të njëjten mesatare si dhe kanë kryer Bachelor në USH, atëherë shpallet fitues kandidati i cili në Provimin e Diplomës/punimin e Diplomës ka notën më të lartë. Nëse dhe ky rast është i njëjtë, fituesi caktohet me short në prani të një komisioni ad-hoc.</p>
	<p>Master Shkencor Studime Regionale në Gjeografi</p>	<p>Të zotërojnë diplomë universitare Bachelor ose të integruar të fituar brenda dhe jashtë vendit, të njohur dhe të klasifikuara sipas ligjit të IAL 80/2015 dhe akteve nënligjore në fuqi.</p>
	<p>Master Profesional në Mësuesi në Gjuhë- Letërsi</p>	<p>Të zotërojnë diplomë universitare Bachelor në Gjuhë - Letërsi, ose diplomë ekuivalente me të, me kohë të plotë apo me kohë të pjesshme, të fituar brenda apo jashtë vendit të klasifikuar sipas ligjit të IAL 80/2015 dhe akteve nënligjore në fuqi.</p> <p>-Nota mesatare në progresion zbritës, nga nota më e lartë tek më e ulëta, në përputhje me kuotat e përcaktuara për programin e studimit.</p> <p>- Nëse konkurojnë më shumë kandidatë se ka kuota në dispozicion dhe kanë të njëjten diplomë të profilit studimor, të njëjten mesatare si dhe kanë kryer Bachelor në USH, atëherë shpallet fitues kandidati i cili në Provimin e Diplomës/punimin e Diplomës ka notën më të lartë. Nëse dhe ky rast është i njëjtë, fituesi caktohet me short në prani të një komisioni ad-hoc.</p>

		Master Profesional në Mësuesi në Histori-Gjeografi	<p>Të zotërojnë diplomë universitare Bachelor në Histori-Gjeografi me drejtim Histori, Histori-Gjeografi me drejtim Gjeografi ose diplomë ekuivalente me të, me kohë të plotë apo me kohë të pjesëshme, të fituar brenda apo jashtë vendit të klasifikuar sipas ligjit të IAL 80/2015 dhe akteve nënligjore në fuqi.</p>
		Master i Shkencave në "Studime të historisë dhe kulturës shqiptare"	<p>Studentët që regjistrohen në këtë program studimi, duhet të zotërojnë diplomë të nivelit të parë (Bachelor) ose të integruar të fituar Brenda dhe jashtë vendit, të klasifikuar sipas ligjit të IAL 80/2015 dhe akteve nënligjore në fuqi</p> <p>Të zotërojnë diplomë Bachelor në: Psikologji, Shkenca mjekësore</p> <p>Të zotërojnë diplomë Master Profesional në: Psikologji, Shkenca mjekësore.</p> <p>Nota mesatare 6</p> <p>Të zotërojnë diplomë Bachelor në: Psikologji, Punë Sociale, Ekonomi, Drejtësi, Mësuesi, Filozofi, Sociologji, Shkenca Politike, Shkenca mjekësore</p> <p>Të zotërojnë diplomë Master Profesional në: Psikologji, Punë Sociale, Ekonomi, Drejtësi, Mësuesi, Filozofi, Sociologji, Shkenca Politike</p> <p>Nota mesatare në progresion zbritës nga nota mesatare më e lartë në notën mesatare më të ulët, në përputhje me kuotat e përcaktuara me programin e studimit.</p> <p>Të ketë mbanur studimet universitare konform aneksisit të Udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2023 MAS.</p> <p>Të zotërojnë diplomë të ciklit të dytë Master i Shkencave, Master I Arteve ose Master Profesional me 120 kredite apo ekuivalente me to të lëshuara nga institucione të arsimit të lartë, program I studimit të të cilave përputhet me një nga fushat/ëndet e mësimdhënies në arsimin</p>
	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	Master Shkencor Psikologji Klinike	
		Master Shkencor Psikologji Organizative	
		Program i studimit të Formimit të Vazhduar në fushën Psiko – Pedagogjike (35 ECTS)	

LUIGJ GURAKUQI

RE

			parauniversitar të përcaktuar në aneksin 1 të Udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2023 MAS. Të kenë mesataren e maturës shtetërore që lejon studiminet Bachelor në Mësuesi sipas ligjeve në fuqi. Nota mesatare në progression zbritës nga nota më e lartë në më të ulët, në përputhje me kuotat e përcaktuara për programin e studimit.
		Master Shkencor në Mësuesi për Biologji – Kimi me profil minore “Karricra dhe aftësimi për jetën”	-Të zotërojnë diplomë Bachelor në: Biologji – Kimi ose të ekuivalentuar me të. -Nota mesatare në progression zbritës nga nota mesatare më e lartë në notën mesatare me të ulët, në përputhje me kuotat e përcaktuara me programin e studimit.
		Master Profesional në Mësuesi për Arsimin Fillor	- Të zotërojnë diplomë Bachelor në: Mësuesi për Arsimin Fillor ose të ekuivalentuar me të. - Nota mesatare në progression zbritës nga nota mesatare më e lartë në notën mesatare me të ulët, në përputhje me kuotat e përcaktuara me programin e studimit.
		Master Profesional në Mësuesi për Edukim Fizik dhe Sporte	- Të zotërojnë diplomë Bachelor në: Mësuesi për Edukimin Fizik dhe Sporte ose të ekuivalentuar me të. - Nota mesatare në progression zbritës nga nota mesatare më e lartë në notën mesatare me të ulët, në përputhje me kuotat e përcaktuara me programin e studimit.
		Master Profesional në Mësues Muzike	Të zotërojnë diplomë Bachelor në fushën e muzikës ose të ekuivalentuar me të. Nota mesatare në progression zbritës nga nota mesatare më e lartë në notën mesatare me të ulët, në përputhje me kuotat e përcaktuara me programin e studimit.
		Master Profesional në Mësuesi i Artit Pamor	Të zotërojnë diplomë Bachelor në fushën e arteve pamore ose të ekuivalentuar me të. Nota mesatare në progression zbritës nga nota mesatare më e lartë në notën mesatare me të ulët, në përputhje me kuotat e përcaktuara me programin e studimit.

INSTITUTI I MËSUESISË
 SHKENCORË DHE ARTISTIKË
 "KARRICRA DHE AFTËSIMI PËR JETËN"


		Master Profesional në Shërbimet Sociale	Të zotërojtë diplomë Bachelor në: Punë Sociale, Psikologji, Sociologji, Arsim Fillor, Arsim Parashkollor. Nota mesatare në progresion zbritës nga nota mesatare më e lartë në notën mesatare më të ulët, në përputhje me kuotat e përcaktuara me programin e studimit.
		Master Profesional në "Pedagogji Speciale"	Të zotërojtë diplomë universitare të nivelit të parë ose të dytë të studimeve në fushën e edukimit. Të zotërojtë diplomë Bachelor në fushën e Psikologjisë, Filozofisë ose Sociologjisë. Nota mesatare në progresion zbritës nga nota mesatare më e lartë në notën mesatare më të ulët, në përputhje me kuotat e përcaktuara me programin e studimit.
	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	Master Profesional në Mësuesi në Gjuhën Angleze Master Profesional në Mësuesi në Gjuhën Italiane	Të zotërojtë diplomë universitare Bachelor në Gjuhë dhe Kulturë Angleze dhe Amerikane, në Gjuhë Angleze ose diplomë ekuivalente me të ne masen 70%. Të zotërojtë diplomë Bachelor në Gjuhë Italiane.
		Master Profesional në Mësuesi në Gjuhën Frënge	Diplomë Bachelor në fushën e studimeve filologjike me kusht zotërimin e një prej certifikatave të gjuhës italiane.
		Master Profesional në Mësuesi në Gjuhën Gjermane	Të zotërojtë diplomë Bachelor në Gjuhë Frënge. Diplomë Bachelor në fushën e studimeve filologjike me kusht zotërimin e një prej certifikatave të gjuhës frënge.
		Master Shkencor në "Financë"	Të zotërojtë diplomë Bachelor në Gjuhë Gjermane.
	Fakulteti Ekonomik	Master Shkencor në "Kontabilitet"	Diplomë Bachelor në fushën e studimeve filologjike me kusht zotërimin e një prej certifikatave të gjuhës gjermane. Rankinimi i studentëve sipas mesatares së fituar në ciklin e parë Bachelor, duke aplikuar si më poshtë:





<p>Master Profesional në "Financë- Bankë"</p>	<p>-Shumëzimi i mesatares së ponderuar të studimeve Bachelor, për studentët me formim ekonomik me koeficientin 1.5. - Shumëzimi i mesatares së ponderuar të studimeve Bachelor, për studentët me formim jo ekonomik me koeficientin 1. Rankimi i studentëve sipas mesatares së fituar në ciklin e parë Bachelor, duke aplikuar si më poshtë: - Shumëzimi i mesatares së ponderuar të studimeve bachelor, për studentët që janë punësuar në administratën publike me koeficientin 1.5. - Shumëzimi i mesatares së ponderuar të studimeve bachelor, për studentët që nuk janë punësuar në administratën publike me koeficientin 1.</p>	<p>-Kandidati të ketë përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve. -Nëse kërkesat janë më të mëdha se kuotat e pranimit të studentëve, renditja bëhet me rend zbritës të notës mesatare të ponderuar dhe kandidati konsiderohet fitues kur nga kjo renditje pozicionohet mbi kufirin e kuotës maksimale të numrit të studentëve për t'u pranuar.</p>
<p>Master Profesional në "Menaxhimi financiar, kontabiliteti dhe kontrolli në administratën publike"</p>	<p>Pranohen student të cilët kanë përfunduar studimet Bachelor në të gjitha fakultetet dhe degët e universiteteve. Renditja e tyre do të bëhet sipas mesatares së studimeve Bachelor. - Në rast të pikëve të barabarta, prioritet kanë ato që kanë përfunduar fakultet Ekonomik dhe degën Administrim – Biznes, FE; dhe ato që kanë përfunduar fakultete Ekonomike.</p>	
<p>Master Shkencor në Administrim Biznesi Master Profesional në Administrim Biznes</p>		
<p>Master Shkencor në Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm Master Profesional në Trashëgimi Kulturor dhe Menaxhimi Turizmi</p>		

		<p>-Kur kandidatët kanë të njëjtën notë mesatare të ciklit të parë të studimeve, t'i llogaritet nota e mbrojtjes së diplomës të ciklit të parë të studimeve.</p>
<p>Fakulteti i Drejtësisë</p>	<p>Master Shkencor në E Drejtë Kushtetuese dhe Administrative</p>	<p>Kriteret e pranimit në Master Shkencor, drejtimi në E Drejtë Kushtetuese dhe Administrative, janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Te gjitha programet, drejtimit e Fakultetit Ekonomik. - Shkolla e policisë, sistemi tre dhe katër vjeçar. - Te gjitha drejtimet e Fakultetit të Shkencave Shogërore. - Te gjitha drejtimet e Fakultetit të Shkencave të Edukimit. - Te gjitha drejtimet e Fakultetit të Shkencave të Komunikimit-Gazetarit. - Shërbime Juridike. - Shërbime Publike. -Administratë Publike. -Shkenca Politike. -Shkenca Filozofike -Në fushën e marrëdhënieve Ndërkombëtare. -Të Drejtësisë Ndërkombëtare -Të Drejtësisë Europiane dhe Studimeve Europiane. -Ekonomi Politike -Politika Ekonomike -Akademia Ushtrake -Degët Informatike - Degët Elektronike -Si dhe të gjithë kandidatët që kanë diploma bachelor në degët e ngjashme me drejtimet e mësipërme.



		<p>Master Shkencor në E drejtë private dhe e biznesit</p>	<p>Kriteret e pranimit në Master Shkencor, drejtimi në E Drejtë Private dhe e Biznesit, janë:</p> <ul style="list-style-type: none">-Të gjitha programet, drejtimit e Fakultetit Ekonomik.- Shkolla e policisë, sistemi tre dhe katër vjeçar.- Të gjitha drejtimit e Fakultetit të Shkencave Shoqërore.- Të gjitha drejtimit e Fakultetit të Shkencave të Edukimit.- Të gjitha drejtimit e Fakultetit të Shkencave të Komunikimit-Gazetari.- Shërbime Juridike.- Shërbime Publike.-Administratë Publike.-Shkenca Politike.-Shkenca Filozofike-Në fushën e marrëdhënieve Ndërkombëtare.-Të Drejtësisë Ndërkombëtare- Të Drejtësisë Europiane dhe Studimeve Europiane.-Ekonomi Politike-Politika Ekonomike-Akademia Ushtrake-Degët Informatike- Degët Elektronike <p>-Si dhe të gjithë kandidatët që kanë diploma bachelor në degët e ngjashme me drejtimit e mësipërme.</p>
--	--	---	---



UNIVERSITETI I MËDIEVEVE DHE FARMACIËS
"I. M. PONI" SHKËRBËRË

Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Master Profesional në Mësuesi në Matematikë me Profil Minor në Informatikë	Aplikantët renditen sipas mesatares së ciklit të parë të studimit, ku studenti duhet të ketë mbaruar programin e ciklit të parë në fushën e Informatikës ose programe të përafërta me të.
	Master Profesional në Mësuesi në Informatikë me Profil Minor në Matematikë	Aplikantët renditen sipas mesatares së ciklit të parë të studimit, ku studenti duhet të ketë mbaruar programin e ciklit të parë në fushën e Matematikës, ose programe të përafërta me të.
	Master Profesional në Mësuesi në Matematikë dhe Fizikë	Kandidatët duhet të kenë përfunduar një diplomë të ciklit të parë të studimeve në fushat e : Fizikë, Biologji, Kimi, Inxhinieri (Elektrike, Elektronike, Kompjuterike, Informatike, Fizike, Matematike) dhe të tjera fusha të këtyre shkencave.
	Master Profesional në Mësuesi në Biologji - Kimi	-Shkenca formale: (Matematikë, logjikë, Statistike, Shkenca kompjuterike dhe fusha të tjera të këtyre shkencave). Mesatarja e ciklit të parë të studimeve, do të shërbejë për rankimin e kandidatëve.
	Master Shkencor në Biologji Mjedisore	Kriteret llogaritur sipas akteve nënligjore në fuqi.. Do të pranohen aplikantët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në programet e studimit Bachelor.
	Master Profesional "Psikologji Shëndeti"	Nota mesatare e programit të ciklit të parë Bachelor në Infermieri e përgjithshme, Infermieri – Mami dhe Fizioterapi. .



KRITERET E PRANIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2025 – 2026
CIKLI I PARË I STUDIMEVE, BACHELOR


KRITERET E PRANIMIT NE UNIVERSITETE 2025 - 2026		
Cikli i Parë i Studimeve (Bachelor)	Programi i studimit	Kriteret
Fakulteti i Shkencave Shogërore	Gjuhë - Letërsi Gazetari dhe Komunikim	80% Nota mesatare e shkollës së mesme, për të gjitha vitet e studimit në arsimin e mesëm (llogaritur sipas akteve nënligjore në fuqi).
		20% Nota mesatare e provimeve të Maturës Shtetërore. 6.5 Nota mesatare, VKM
	Gjeografi Gjeografi dhe zhvillim territori	70% Nota mesatare e shkollës së mesme, për të gjitha vitet e studimit në arsimin e mesëm (llogaritur sipas akteve nënligjore në fuqi).
		30% Nota mesatare e provimeve të Maturës Shtetërore
		70% Nota mesatare e shkollës së mesme, për të gjitha vitet e studimit në arsimin e mesëm (llogaritur sipas akteve nënligjore në fuqi).
	Histori Histori dhe Trashëgimi kulturore	30% Nota mesatare e provimeve të Maturës Shtetërore
Fakulteti i Shkencave të Edukimit	Mësuesi për Arsimin Fillor Mësuesi për Arsimin Parashkollor	80% Nota mesatare e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, përfshirë edhe provimet e Maturës Shtetërore (llogaritur sipas akteve nënligjore në fuqi).
		20% Provimet e Maturës Shtetërore.



			<p>30% Nota mesatare e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, pëfshirë edhe provimet e Maturës Shtetërore (llogaritur sipas akteve nënligjore në fuqi).</p> <p>70% konkursi i pranimit.</p> <p>40% Nota mesatare e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, pëfshirë edhe provimet e Maturës Shtetërore (llogaritur sipas akteve nënligjore në fuqi).</p> <p>60% nota mesatare e lëndëve të zhvilluara, nga grupi i lëndëve: Qytetari, Psikologji, Filozofi, Sociologji.</p> <p>Kriteri i pranimit të studentëve, Bachelor në Financë – Kontabilitet për vitin 2025 – 2026, të jetë plotësimi i notës mesatare (llogaritur sipas akteve nënligjore në fuqi) dhe renditja e tyre sipas mesatares.</p> <p>Nëse aplikantët rezultojnë me pikë të barabarta, renditja e tyre do të bëhet duke llogaritur notën mesatare të provimeve të maturës shtetërore për lëndët: Matematikë dhe Ekonomi ose do merret në konsideratë nota e provimit të lëndës Matematikë në rastin kur studentit nuk ka dhënë provim lëndën Ekonomi.</p> <p>Kriteri i pranimit të studentëve, Bachelor në Administrim – Biznes për vitin 2025 – 2026, të jetë plotësimi i notës mesatare të shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë edhe provimet e maturës shtetërore (llogaritur sipas akteve nënligjore në fuqi).</p> <p>Kriteri i pranimit të studentëve, Bachelor në Turizëm për vitin 2025 – 2026, të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Çdo kandidat të ketë përfunduar me sukses arsimin e mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare (llogaritur sipas akteve nënligjore në fuqi). - Çdo kandidati që rezulton nga llogaritja e kriterit të mësipërm me pikë të barabarta me studentin që pozicionohet përtej
		<p>Pedagogji muzikore Pikturë dhe grafikë Edukim Fizik dhe Sporte</p> <p>Psikologji Punë sociale</p> <p>Financë- Kontabilitet</p> <p>Administrim-Biznes</p> <p>Turizëm</p>	
	Fakulteti Ekonomik		



			<p>kufirit të kuotës maksimale të numrit të studentëve për tu pranuar, t'iu merren në llogaritje nota mesatare e Provimëve të Maturës.</p> <p>Mesatarja aritmetike e shkollës së mesme, + mesatarja e provimeve të Maturës Shtetërore (llogaritur sipas akteve nënligjore në fuqi).</p>
	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	<p>Gjuhë angleze Gjuhë Italiane Gjuhë Frënge Gjuhë Gjermane</p>	<p>50% Nota mesatare e shkollës së mesme (llogaritur sipas akteve nënligjore në fuqi). 30% Pikët e kandidatit në grup- lëndët e Matematikës 10% Pikët e kandidatit në grup- lëndët e TIK 10% Pikët e kandidatit në grup- lëndët e Fizikës</p>
	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	<p>Matematikë</p>	<p>Koeficienti i shkollës së mesme, i cili vendoset nga departamenti, gjithmonë në lidhje me drejtimin që përfaqëson gjinnazi, shumëzohet me shumën e numrave të llogaritur në katër pikat e mësipërme.</p>
			<p>50% Nota mesatare e shkollës së mesme (llogaritur sipas akteve nënligjore në fuqi). 40% Pikët e kandidatit në grup- lëndët e TIK 10% Pikët e kandidatit në grup- lëndët Gjuhë e Huaj</p>
		<p>Informatikë</p>	<p>Koeficienti i shkollës së mesme, i cili vendoset nga departamenti, gjithmonë në lidhje me drejtimin që përfaqëson gjinnazi, shumëzohet me shumën e numrave të llogaritur në tre pikat e mësipërme</p>
			<p>50% Nota mesatare e shkollës së mesme (llogaritur sipas akteve nënligjore në fuqi). 20% Pikët e kandidatit në grup- lëndët e Fizikës 20% Pikët e kandidatit në grup- lëndët e Matematikës 10% Pikët e kandidatit në grup- lëndët Informatikës</p>
		<p>Fizikë</p>	





			Nota Mesatare e shkollës së Mesme (Matura Shtetërore), bazuar sipas akteve nënligjore në fuqi.
	Biologji-Kimi		Nota Mesatare e shkollës së Mesme (llogaritur sipas akteve nënligjore në fuqi).
	Shkencat e ushqimit		50% nota mesatare e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, përfshirë edhe provimet e Maturës Shtetërore Mesme (llogaritur sipas akteve nënligjore në fuqi).
	Infermieri e Përgjithshme		50 % nota mesatare e lëndëve bazë Kimi dhe Biologji për degët Infermieri dhe Mami.
	Fizioterapi		50% nota mesatare e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, përfshirë edhe provimet e Maturës Shtetërore Mesme (llogaritur sipas akteve nënligjore në fuqi).
	Infermieri - Mami		50 % nota mesatare e lëndëve bazë Fizikë dhe Biologji.
			50% nota mesatare e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, përfshirë edhe provimet e Maturës (llogaritur sipas akteve nënligjore në fuqi).
	Bachelor/ Program i Integruar studimeve të ciklit të dytë Master i shkencave në "Drejtesia" (cikël 5 vjeçar)		50 % nota mesatare e lëndëve bazë Kimi dhe Biologji. Kriteret e pranimit të studentëve në programin e studimit Bachelor/ Program i Integruar i studimeve të ciklit të dytë Master i shkencave në "Drejtesia" (cikël 5 vjeçar), bazohet vetëm në mesataren llogaritur sipas akteve nënligjore në fuqi. Në rast pikësh të barabarta do të merret në konsideratë mesatarja e grup lëndëve: Histori, Qytetari, Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, Ekonomi, Sociologji, Psikologji.
Fakulteti i Drejtësisë			

KRITERET E PRANIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2025 – 2026
PROGRAM STUDIUMI ME KARAKTER PROFESIONAL

KRITERET E PRANIMIT NE UNIVERSITETE 2025 - 2026		
Program studimi me karakter profesional		
Fakulteti	Programi i studimit	Kriteret
Fakulteti i Shkencave Shogërore	Program studimi me karakter profesional “Udhërrëfyes Turistik dhe Menaxhues i Itinerareve Turistike për Rajonin Venor”	70% Nota mesatare e shkollës së mesme, për të gjitha vitet e studimit në arsimin e mesëm (logaritur sipas akteve nënligjore në fuqi).
		50% nota mesatare e shkollës së mesme 20% nota e grup-lëndëve në TIK 20% nota e grup-lëndëve në Matematikë 10% nota e grup-lëndëve në Fizikë Koefficienti i shkollës së mesme i cili vendoset nga departamenti, në lidhje me drejtimin që përfaqëson gjimnazi.
Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Program studimi me karakter profesional “Teknik Sistemesh dhe Rrjetesh Kompjuterike”	50% nota mesatare e shkollës së mesme 20% pikët e kandidatit në grup-lëndët e Fizikës 20% pikët e kandidatit në grup-lëndët e Matematikës 10% pikët e kandidatit në grup-lëndët e Informatikës
	Program studimi me karakter profesional “Specialist i lartë elektrik”	



KRITERET E PRANIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2025 – 2026
CIKLI I TRETË, DOKTORATË

KRITERET E PRANIMIT NE UNIVERSITETE 2025 - 2026

KRITERET E PRANIMIT NE UNIVERSITETE 2025 - 2026			
Cikli i tretë i Studimeve	Doktoraturë në "Gjuhë Shqipe"	Programi i studimit	Kriteret
IAL	Fakulteti		
	Fakulteti i Shkencave Shqiptore	Doktoratë në "Gjuhë Shqipe"	<p>-Të ketë notë mesatare të përgjithshme të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve 8 e lart.</p> <p>-Të njohë një prej 5 (pesë) gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një program studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar i shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. -</p>
	Fakulteti Ekonomik	Doktoratë në "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm"	<p>Pasi të miratohet nga MAS rregullorja e përditësuar e organizimit të Doktoratë në "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm".</p>